# Doracak përdorimi

**për projektin**

# REGJISTRI KOMBËTAR I PERFORMANCËS SË ENERGJISË NË NDËRTESA

Prishtinë, Prill 2019

# Përmbajtja

Qëllimi ........ 3
Hyrje ........ 3
Ballina ........ 4
Kyçja në aplikacion ........ 5
Gjuha e aplikacionit ........ 7
Ndihma ........ 7
Ndërtesat ........ 8
Vlerësuesit ........ 9
Të dhënat ndihmëse ........ 12
    Regjistrimi ........ 12
    Modifikimi ........ 13
    Fshirja ........ 13
EPC Aplikacionet ........ 14
Raportet ........ 18
Administrimi ........ 20
    Shfrytëzuesit ........ 20
    Rolet ........ 21
    Profili i shfrytëzueseve ........ 23
Lista e Figurave ........ 24

## Qëllimi

Qëllimi i këtij dokumenti është që të përshkruaj aktivitetet të cilat realizohen me anë të sistemit për Regjistrin Kombëtar të Përformancës së Energjisë në Ndërtesa ( ang. National Registry of Energy Performance in Buildings) - NREPB.

Dokumenti do ti shpalosë vetitë e sistemit, ndërlidhjet e sistemit, si do të funksionoj sistemi, me cilat funksionalitete do të disponoj sistemi dhe kondidat në të cilat do të operoj sistemi.

Ky dokument shërben si material udhëzues për përdorimin e aplikacionit, për stafin e Agjencisë e Kosovës për Efiçencë të Energjisë – AKEE, zyrtarëve nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – MMPH dhe vlerësueseve të energjisë.

## Hyrje

Sistemi Informativ për Regjistrin Kombëtar të Përformancës së Energjisë në Ndërtesa - NREPB është një aplikacion softuerik i zhvilluar në platformën ueb dhe për qëllim kryesor ka krijimin e listës apo regjistrit kombëtar të përformancës së energjisë në ndërtesat publike edhe ato private në Kosovë.

Ky aplikacion është i qasshëm ne linkun: http://gzk.komtelpe.net/NREPB/

Në sistem do të kenë qasje dy lloje të shfrytëzuesve.

1. Shfrytëzuesit publik, të cilët nuk kanë nevojë për autentifikim në sistem dhe të cilët do të kenë qasje vetëm në raportet që gjenerohen nga sistemi dhe për të cilat është menduar që mund të jenë të hapura për publikun
2. Shfrytëzuesit e brendshëm të sistemit, të cilët mund ti qasen sistemit duke u autentifikuar në sistem me anët llogarisë së tyre. Këta shfrytëzues mund të jenë : shfrytëzuesit nga AKEE, shfrytëzuesit nga MMPH dhe vlerësuesit e energjisë.

Në vijim do të përshkruhen funksionalitet kryesore të aplikacionit.

## Ballina

Ballina është pjesa e fillestare e aplikacionit e cila shfaqet pa qasjes së aplikacionit në linkun për qasje.

Në këtë ndërfaqe kanë qasje të gjithë llojet e shfrytëzuesve dhe nuk ka nevojë për autentifikim. Në pjesën e djathë të ndërfaqes janë paraqitur linqet për qasje më të shpejtë në raportet publike, ndërsa më poshtë është butoni për autentifikim për shfrytëzuesit e brendshëm të aplikacionit.




Figura 1: Ballina e aplikacionit

Pas klikimit në njërin nga linqet e shpejta nga figura e mësipërme, hapet faqja ndërvepruese si në figurën vijuese, ku paraqiten të dhënat për raportin e zgjedhur.




Figura 2: Raportet publike

Nga kjo ndërfaqe shfrytëzuesi mund të zgjedh edhe raportet tjera publike. Në këto raporte paraqiten vetëm ndërtesat që kanë certifikatë energjetike  valide.

Vetëm për ndërtesat publike dhe ato të qeverisë, shfrytëzuesit mund të shikojnë detajet e certifikatës së energjisë duke klikuar në butonin Download EPC

Lista e vlerësuesve i paraqet të dhënat e vlerësuesve të cilët kanë licencë valide të certifikimit të energjisë.

Të dhënat e të gjitha raporteve mund të eksportohen në Excel duke klikuar në butonin Excel
Filtrimi i të dhënave në të gjitha listat bëhet duke shkruar kërkesën për filtrim në fushën ***Search***. Në rastet kur listat kanë numër të madh të të dhënave, kalimi nga një listë në tjetrën realizohet me anë të butonave Previous 1 Next

## Kyçja në aplikacion

Qasja në NREPB mund të bëhet duke shënuar të dhënat e llogarisë (shfrytëzuesi dhe fjalëkalimi)  të secilit shfrytëzues. Këto të dhëna janë regjistruar paraprakisht nga administratori i sistemit.

Autentifikimi në sistemin NREPB mundësohet duke klikuar në butonin Authorized user access → nga ballina Figura 1, apo duke klikuar në butonin Login nga lista e raporteve publike, Figura 2.

Pastaj hapet forma si në figurën vijuese në të cilën shfrytëzuesi i shkruan të dhënat e tij.




Figura 3: Forma për kyçje në aplikacion

Aplikacioni ruan historikun e ndryshimeve pas çdo tentim kyçeje.
Pas tri tentim kyçjeve të pa suksesshme aplikacioni automatikisht e bllokon shfrytëzuesin përkatës.
Administratori i sistemit mund ta ç' bllokoj shfrytëzuesin e bllokuar.

Menyja e aplikacionit e cila paraqitet në ballinë pas autentifikimit të shfrytëzuesit, shfaqet varësisht nga të drejtat e shfrytëzuesit të kyçur në aplikacion. Pra disa shfrytëzues mund të shohin disa opsione në menynë e aplikacionit e disa të tjerë opsione tjera.

Opsionet e kufizuara me ngjyre të kuqe  në figurën vijuese nuk janë valide për këtë version të aplikacionit. Ato parashihen që të implementohen në fazat tjera.




Figura 4: Menyja kryesore e aplikacionit

## Gjuha e aplikacionit

Shfrytëzuesit mund ta ndryshojnë gjuhen e operimit të aplikacionit, përmes opsioneve të paraqitura në figurën vijuese, Figura 5. Me këtë veprim, i tërë aplikacioni operon në gjuhen e zgjedhur.

Fillimisht aplikacioni hapet në gjuhen të cilën iu është caktuar shfrytëzuesit, gjatë regjistrimit të tij nga administratori i sistemit.




Figura 5: Opsionet për ndryshimin e gjuhës së aplikacionit

## Ndihma

Të gjithë shfrytëzuesit mund ta shkarkojnë doracakun e përdorimit të aplikacionit duke klikuar në butonin nga figura vijuese.

Ky dokument mund të shkarkohet në gjuhën shqipe dhe serbe, varësisht se në çfarë gjuhe është duke operuar shfrytëzuesi.




Figura 6: Shkarkimi i manualit të përdorimit

# Ndërtesat

Lista e ndërtesave paraqitet pas klikimit të butonit “ Ndërtesat” nga menyja kryesore e aplikacionit.

Në këtë listë paraqiten të gjitha ndërtesat e regjistruara në sistem. Me anë të opsioneve Edit Details Delete mundësohet modifikimi, paraqitja e të gjitha të dhënave për një ndërtesë dhe fshirja e një ndërtesa nga baza e të dhënave.

Me anë të butonit “Excel” mundësohet eksportimi i listës së ndërtesave në fajllin e formatit Excel, ndërsat fusha “Search” mundëson filtrimin e të dhënave të paraqitura në listën e ndërtesave sipas kritereve të vendosura nga shfrytëzuesi.




Figura 7: Lista e ndërtesave

Me anë të butonit “Create New”, mundësohet regjistrimi i një ndërtese të re. Pas klikimit të këtij butoni hapet forma vijuese në të cilën shfrytëzuesit i vendosin të dhënat e kërkuara.

Në pjesën e djathtë të formës, figura 9, shfrytëzuesit mund të vendosë të dhënat GPS për ndërtesën apo të kërkoj lokacioni e të njëjtës në hartë.

Shfrytëzuesit gjithashtu mund të ngarkojnë të gjitha dokumentet relevante të ndërtesës me anë të pjesës së fundit të kësaj forme, Figura 9.

Dokumentet që lejohen të ngarkohen duhet që ti takojnë një nga formateve të theksuara në figurën 9.




Figura 8: Forma për regjistrimin e një ndërtese të re

## Vlerësuesit

Lista e vlerësuesve paraqitet pas klikimit të butonit “ Vlerësuesit” nga menyja kryesore e aplikacionit.

Në këtë listë paraqiten të gjithë vlerësuesit e regjistruar në sistem.

Me anë të opsioneve 

mundësohet modifikimi, paraqitja e të gjitha të dhënave për një vlerësues dhe fshirja e një vlerësuesi nga baza e të dhënave. Me anë të butonit “Excel” mundësohet eksportimi i listës së vlerëseseve në fajllin e formatit Excel, ndërsat fusha “Search” mundëson filrtrimin e të dhënave të paraqitura në listën e vlerësuesëve sipas kritereve të vendosura nga shfrytëzuesi.




| Name | PersonalNo | LicenceNo | Licence Type | Licence Status | Expiry Date | District | E-mail | Telephone | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Assessor Assessor | 1247811 | LI/9756/03/21 | Assessor | Valid | 08.03.2021 | Prishtinë | myname@gmail.com | +377 44 237 709 | Edit Details Delete |
| Rinor Asllani | 2912038192 | LI/8942/03/18 | Assessor | Valid | 13.03.2023 | Fushë Kosovë | rinor.asllani@gmail.com | +386 49 685 998 | Edit Details Delete |
| Shkumbin Spahija | 1001295019 | LI/2645/02/20 | Assessor | Valid | 02.01.2018 | Prishtinë | shkumbin.spahija@live.com | +386 49 605 005 | Edit Details Delete |
| Venera Komoni | 1171840321 | LI/2439/03/15 | Assessor | Valid | 08.03.2020 | Prishtinë | venerakomoni@hotmail.com | +377 44 637 724 | Edit Details Delete |

Figura 9: Lista e vlerësuesve të regjistruar

Me anë të butonit “Create New”,nga figura e mësipërme mundësohet regjistrimi i një vlerësuesi të ri. Pas klikimit të këtij butoni hapet forma vijuese në të cilën shfrytëzuesit i vendosin të dhënat e kërkuara.




Figura 10: Regjistrimi i një vlerësuesi të ri

Gjatë procesit të regjistrimit të vlerësuesit, sistemi mundëson ngarkimin e dokumenteve relevante për vlerësuesin. Gjithashtu gjatë këtij procesi krijohet edhe llogaria të cilin vlerësuesi mund ta përdorë për qasje në sistem. Administratori i sistemit apo ndonjë shfrytëzues me të drejta, gjatë regjistrimit të vlerësuesit e vendosë edhe UserName-in e tij. Paswordi apo fjalëkalimi gjenerohet automatikisht nga sistemi, të cilin fjalëkalim vlerësuesi mund ta ndryshoj pas kyçjes në herën e parë në sistem.

Vendosja e të dhënave për licencat e vlerësuesve mundësohet duke klikuar në butonin 

nga figura 10. Pas këtij veprimi hapet mundëlsia si në figuren vijuese, figura 11.




Figura 11: Regjistrimi i licencave për vlerësuesin

Shfrytëzuesi me të drejta të caktuara mund të ndryshoj statusin e një licence të vlerësuesit (psh në Revoke, Cancel etj), duke klikuarr fillimisht në butosnin "Edit", figura 9 dhe pastaj duke ndjekur udhëzimet si në figurën vijuese, figura 12




Figura 12: Ndryshimi i statusit të licencës së vlerësuesit

## Të dhënat ndihmëse

Të dhënat mbështetëse janë të dhëna të cilat administrohen nga administratori i sistemit, ndërsa shfrytëzuesit e zakonshëm i përdorin ato nëpër format ku ju duhen.

Në figurën vijuese janë paraqitur të gjitha të dhënat mbështetëse të cilat mund të menaxhohen nga administratori i sistemit.

Menaxhimi i të gjitha të dhënave ndihmëse të paraqitura në figurën vijuese është i njëjtë.

Me anë të butonit "Excel" mundësohet eksportimi i listës së vlerësesëve në fajllin e formatit Excel, ndërsat fusha "Search" mundëson filtrimin e të dhënave të paraqitura në listën e vlerësuesëve sipas kritereve të vendosura nga shfrytëzuesi

Për qëllim të shpjegimit në vijim do të përshkruhet menaxhimi i "Llojet e ndërtesave".




Figura 13: Menaxhimi i të dhënave ndihmëse

## Regjistrimi

Regjistrimi i një "Lloji të ndërtesave" , mundësohet duke klikuar në butonin " I ri", nga figura e mësipërme. Me këtë rast hapet një dritare tjetër ku shfrytëzuesi duhet që të plotësojë të dhënat e kërkuara.




Figura 14: Vendosja e Llojeve të ndërtesave

## Modifikimi

Editimi apo modifikimi i një lloji të ndërtesave , mundësohet duke klikuar në butonin "Edito", 

nga Figura 14.

Me këtë rast hapet një dritare, me të dhënat e plotësuara për rreshtin e zgjedhur, si në figurën në vijim.




Figura 15: Modifikimi i llojeve të ndërtesave

## Fshirja

Fshirja e një "lloji të ndërtesave", mundësohet duke klikuar në butonin fshije të rreshtit përkatëse, të paraqitur në figurën 13. 


Mund të fshihen vetëm të dhënat të cilat nuk janë përdorur gjatë regjistrimit të rasteve. Përndryshe nëse ka të paktën një rast të regjistruar me atë rekord, sistemi nuk lejon fshirjen e saj.

## EPC Aplikacionet

Me anë të këtij opsioni mundësohet menaxhimi i aplikacioneve për EPC. Ky është një proces i cili zhvillohet nga shfrytëzuesit me rolin e vlerësuesve dhe atyre me të drejta të zyrtarëve nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – MMPH apo MESP.

Procesi kalon nëpër disa hapa, ku për çdo hap aplikacioni e ndërron statusin varësisht nga faza në të cilën ndodhet.

Në tabelën vijuese janë paraqitur statuset nëpër të cilat kalon një aplikacion EPC, përshkrimi i secilit status, si dhe roli përgjegjës i cili e dërgon aplikacionin EPC në atë status.

Hapat e rregullt nëpër të cilët kalon një aplikacion i EPC deri në finalizim janë: Create, Send, Approved, MESP dhe Issued

| Statusi | Përshkrimi | Roli përgjegjës |
|---|---|---|
| Create / Krijuar | Krijohet aplikacioni dhe ruhet nga shfrytëzuesi | Assesor/Vlerësues |
| Send / Dërguar | Shfrytëzuesi e dërgon për aprovim aplikacionin në MESP/MMPH | Assesor/Vlerësues |
| Approved / Aprovuar | Shfrytëzuesi nga MESP/MMPH e aprovon aplikacionin | MESP/MMPH |
| MESP/MMPH | Vlerësuesi e dërgon aplikacionin e plotësuar në MESP/MMPH për fazën finale për të lëshuar një EPC | Assesor/Vlerësues |
| Issued/ lëshuar | Shfrytëzuesi nga MESP/MMPH e aprovon aplikacionin | MESP/MMPH |
| Revoke/ Tërhequr | Shfrytëzuesi nga MESP/MMPH e tërheq një aplikacion të lëshuar më parë | MESP/MMPH |
| Draft/ Draft | Shfrytëzuesi nga MESP/MMPH e kthen aplikacionin tek vlerësuesit për plotësim apo ndryshim të aplikacionit | MESP/MMPH |
| Cancel / Anuluar | Shfrytëzuesi nga MESP/MMPH e anulon një aplikacion I cili ende gjendet në procedurë | MESP/MMPH |

Tabela 1: Statuset e aplikacioneve EPC

Lista e aplikacioneve EPC paraqitet duke klikuar në butonin "EPC Aplikacionet" nga menyja kryesore.

Me këtë rast paraqitet forma si në figurën vijuese.

Fusha Statusi nga kjo figurë paraqet statusin aktual se ku ndodhet aplikacioni, ndërsa fusha ditët paraqet numrin e ditëve për të cilat aplikacioni është në atë status në nga veprimi i fundit




Figura 16: Lista e EPC aplikacioneve

Me anë të butoni "Iri", mundësohet krijimi i një aplikacioni të ri EPC. Këtë mundësi do ta kenë vetëm shfrytëzuesit me rolin vlerësues (assessor).

Butoni "Action", shërben për të paraqitur një opsion tjetër me disa butona të cilët paraqiten varësisht se në cilën fazë apo status ndodhet aplikacioni.

| Butonat | Statusi | Roli përgjegjës | Përshkrimi |
|---|---|---|---|
| Send/Edit/Delete | Create / Krijuar | Assesor/ Vlerësues | Mundësohet:<br>• Fshirja e aplikacionit të regjistruar<br>• Modifikimi i të njëjtit<br>• Dërgimi për aprovim |
| Aprove/Cancel | Send / Dërguar | MESP/MMPH | Mundësohet:<br>• Aprovimi dhe kthimi tek vlerësuesi për plotësim<br>• Anulimi i aplikacionit |
| Preview/Submit/ Next Step | Approved / Aprovuar | Assesor/ Vlerësues | Mundësohet:<br>• Plotësimi i aplikacionit me të dhënat shtesë<br>• Dërgimi në hapin final<br>• Paraqitja e EPC certifikatës |
| Reject/Finish | MESP/MMPH | MESP/MMPH | Mundësohet:<br>• Pranimi përfundimtar i aplikacionit<br>• Kthimi i aplikacionit për plotësim tek vlerësuesi |
| Download/Shkarko | Issued/ lëshuar | Assesor/ Vlerësues | Mundësohet shkarkimi i EPC certifikatës në formatin pdf dhe printimi i saj |
| Revoke/ Tërhequr | Revoke/ Tërhequr | MESP/MMPH | Mundësohet anulimi i një EPC certifikate të lëshuar më parë |
| Preview/Submit/ Next Step | Draft/ Draft | Assesor/ Vlerësues | Mundësohet:<br>• Plotësimi i aplikacionit me të dhënat shtesë<br>• Dërgimi në hapin final<br>Paraqitja e EPC certifikatës |

Tabela 2: Butonat gjatë procesit të EPC

Në tabelën e mësipërme është paraqitur një pasqyrë e butonave që paraqiten varësisht se në cilin status ndodhet EPC Aplikacioni.

Në kolonën "Butonat" janë butonat të cilët paraqiten varësisht se në cilin status ndodhet aplikacioni, kolona "Statusi" paraqet statusin e aplikacionit, kolona "Roli përgjegjës" paraqet llojin e shfrytëzuesve të cilët kanë qasje në ata butona, ndërsa kolona "Përshkrimi" përshkruan llojet e aktiviteteve që mund të realizohen me butonat e paraqitur.

Figura në vijim paraqet rrjedhën normale te procesit nga momenti i inicimit të aplikacionit EPC deri në përfundimin e tij kur mundësohet printimi i certifikatës EPC.




Figura 17: Procesi i aplikacioneve CPC

Në vijim do të përshkruhen aktivitet e butonave nga fora fillestare e listës së aplikacioneve EPC, figura 16.

| Butoni | Përshkrimi | Aktiviteti vijues |
|---|---|---|
|   | Pas klikimit të këtij butoni hapet forma me tre butona tjerë, nga ku duhet të zgjidhet aktiviteti vijues |   |
|   | Mundëson shkarkimin e EPC certifikatës në formatin pdf | |
|   | Dërgohet aplikacioni në fazën tjetër tek aplikacionit. | |
|   | Anulohet aplikacioni, pra ndërpritet procesi i certifikatës EPC |   |
|   | Aprovohet certifikata EPC, përfundon procesi i aplikacionit EPC | |
|   | Aplikacioni kthehet tek vlerësuesi për plotësim apo korrigjim |   |
|   | Hapet forma për plotësimin e aplikacionit |   |

Figura 18: Përshkrimi i butonave gjatë procesit të aplikacioneve CPC

## Raportet

Me opsionin Raportet nga menyja kryesor paraqitet lisa e aplikacioneve EPC në çfarëdo statusi në të cilën janë ato.

Këtë raport mund ta shohin vetëm shfrytëzuesit e autentifikuar në sistem dhe të cilat kanë të drejtat e paracaktuar për qasje në këtë raport.

Me anë të butonit “Excel” mundësohet eksportimi i listës së vlerëseseve në fajllin e formatit Excel, ndërsat fusha “Search” mundëson filrtrimin e të dhënave të paraqitura në listën e vlerësueseve sipas kritereve të vendosura nga shfrytëzuesi




Figura 19: Lista e aplikacioneve EPC

Me anë të butonit “Info”, si në figurën vijuese paraqiten veprimet për një aplikacion me të gjitha statuset të cilat janë ndërmarrë nga shfrytëzuesit e caktuar.

Duke klikuar në butonin “Print” shfrytëzuesit kanë mundësinë për të printuar përmbajtjen e figurës vijuese.

Me anë të butonit  mundësohet shkarkimi i certifikatës EPC në formatin pdf.

Ndërsa me anë të butonit Details paraqiten të dhënat e plotësuara për një EPC.
Në figurën 18 janë paraqitur disa nga të dhënat e plotësuara për një EPC.




| From Status | To status | Comment | Date | By |
|---|---|---|---|---|
| Created | Sent | Sended to Ministry | 11/04/2019 | assessor |
| Sent | Approved | Sended to Assessor | 11/04/2019 | mesp |
| Approved | MESP | Sended to MESP | 11/04/2019 | assessor |
| MESP | Issued | Sended to Assessor [Finished] | 15/04/2019 | mesp |
| Issued | Revoke | disa te dhena nuk jane te sakta | 15/04/2019 | admin |

Figura 20: Paraqitja e hapave të aprovimit për një EPC




Figura 21: Të dhënat e plotësuara për një EPC

# Administrimi

Me anë të opsionit Administrimi nga menyja kryesore në të cilin kanë qasje vetëm shfrytëzuesit me të drejta administrative, mundësohet menaxhimi i shfrytëzuesve të aplikacionit dhe roleve të tyre.

## Shfrytëzuesit

Pas zgjedhjes së opsionit të Administrimit nga menyja kryesore, hapet forma si në figurën vijuese. Kjo formë paraqet listën e të gjithë shfrytëzuesve të regjistruar që kanë qasje në sistem.




Figura 22: Forma për menaxhimin e shfrytëzuesve

Me anë të butonit "I ri" mundësohet regjistrimi I një shfrytëzuesi  të ri. Siç mund të vërehet edhe nga figura e mëposhtme me anë të këtij opsioni nuk mund të regjistrohet shfrytëzues me të drejtat e vlerësuesit, pasi që ky rol hapet gjatë regjistrimit të vlerësuesit.




Figura 23: Regjistrimi i një shfrytëzuesi të ri

Modifikimi i të dhënave për shfrytëzuesit apo edhe fshirja e tij nga sistemi bëhet me anë të butonave përkatës 


Me anë të opsionit Edit, mund të bëhet edhe ndryshimi i fajlëkalimit të ndonjshfrytëzuesi nga ana e administratorit apo edhe ndalimi i qasjes në sistem me anë të opsioit 


## Rolet

Të drejtat e një shfrytëzuesi në sistem menaxhohen me anë të roleve.

Në figurën vijuese është paraqitur lista e roleve në aplikacion.




Figura 24: Menaxhimi i roleve

Me anë të butonit "iRi" mundësohet krijimi i një roli të ri, me këtë rast hapet një formë tjetër si në figurën vijuese.




Figura 25: Regjistrimi i një roli të ri

Konfigurimi i të drejtave për një rol, realizohet duke klikuar në butonin "Edito", nga figura 24, me këtë rast hapet një formë tjetër si në figurën vijuese.

Role - Admin

| Page Name | Access | Show in Menu |
|---|---|---|
| Districts | ☑ | |
| Edit | ☑ | |
| Create | ☑ | |
| Delete | ☑ | |
| Roles | ☑ | |
| Edit | ☑ | |
| Create | ☑ | |
| Delete | ☑ | |
| Support Data | ☑ | ☑ |
| Buildings | ☑ | ☑ |

Figura 26: konfigurimi i të drejtave për një rol

## Profili i shfrytëzueseve

Menaxhimi i profilit për secilin shfrytëzues nga vet shfrytëzuesi mundësohet duke klikuar në emrin e shfrytëzuesit nga menyja kryesore, si në fotografinë vijuese

Me anë të këtij opsioni mundësohet ndryshimi i të dhënave bazike për shfrytëzuesin përkatës sikurse janë emri dhe mbiemri, apo edhe ndryshimi i fjalëkalimit me anë të opsionit " Ndrysho fjalëkalimin". Në këtë rast hapet dritarja përkatëse që mundëson vendosjen e të dhënave për ndryshimin e fjalëkalimit, si në figurën 22




Figura 27: Menaxhimi i profilit të shfrytëzuesit




Figura 28: Ndryshimi i fjalëkalimit

## Lista e Figurave

Figura 1: Ballina e aplikacionit ... 4

Figura 2: Raportet publike ... 5

Figura 3: Forma për kyçje në aplikacion ... 6

Figura 4: Menyja kryesore e aplikacionit ... 6

Figura 5: Opsionet për ndryshimin e gjuhës së aplikacionit ... 7

Figura 6: Shkarkimi i manualit të përdorimit ... 7

Figura 7: Lista e ndërtesave ... 8

Figura 8: Forma për regjistrimin e një ndërtese të re ... 9

Figura 9: Lista e vlerësuesve të regjistruar ... 10

Figura 10: Regjistrimi i një vlerësuesi të ri ... 10

Figura 11: Regjistrimi i licencave për vlerësuesin ... 11

Figura 12: Ndryshimi i statusit të licencës së vlerësuesit ... 11

Figura 13: Menaxhimi i të dhënave ndihmëse ... 12

Figura 14: Vendosja e Llojeve të ndërtesave ... 13

Figura 15: Modifikimi i llojeve të ndërtesave ... 13

Figura 16: Lista e EPC aplikacioneve ... 15

Figura 17: Procesi i aplikacioneve CPC ... 16

Figura 18: Përshkrimi i butonave gjatë procesit të aplikacioneve CPC ... 17

Figura 19: Lista e aplikacioneve EPC ... 18

Figura 20: Paraqitja e hapave të aprovimit për një EPC ... 19

Figura 21: Të dhënat e plotësuara për një EPC ... 19

Figura 22: Forma për menaxhimin e shfrytëzuesve ... 20

Figura 23: Regjistrimi i një shfrytëzuesi të ri ... 20

Figura 24: Menaxhimi i roleve ........ 21

Figura 25: Regjistrimi i një roli të ri ........ 21

Figura 26: konfigurimi i të drejtave për një rol ........ 22

Figura 27: Menaxhimi i profilit të shfrytëzuesit ........ 23

Figura 28: Ndryshimi i fjalëkalimit ........ 23